



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 192/26 Dt. 30.04.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58, shkronja e) dhe nenit 60 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), neni 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 03/2023 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në komuna, dhe nenit 50 shkronja e), 51 dhe 53 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

1. Kujtim Gashi emërohet në pozitën e Nënkyetarit në Komunën e Prizrenit.
2. Mandati i nënkryetarit të Komunës do të fillon nga data 30 prill 2026 dhe do të jetë i njëjtë me mandatin e kryetarit të Komunës. Emërimi i bërë me këtë vendim mund të rishqyrtohet në çdo kohë nga kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e ligjit dhe akteve tjera nënligjore.
3. Detyrat dhe përgjegjësit e nënkryetarit, janë të përcaktuara me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Statutin e Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, si dhe me udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të Komunës, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.
4. I emëruari i ndihmon kryetarit të Komunës në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij.
5. Obligohet i emëruari, Kabineti i Kryetarit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore,
 - Kabinetit të Kryetarit,
 - Të emëruarit,
 - Arkivës së Kryetarit.